



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAM MËSIMOR PËR CIKLIN FILLOR

**LËNDA: Gjuha frënge
(klasa e pestë)**

VITI SHKOLLOR 2007-2008

Tiranë , 2008

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

I. TË PËRGJITHSHME

II. SYNIMET E PROGRAMIT

III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE

IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT


- 1. Tematika dhe leksiku**
- 2. Aktet dhe funksionet e komunikimit**
- 3. Struktura gramatikore**
- 4. Shpërndarja e orëve**

V. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

VI. VLERËSIMI

I. Të përgjithshme

Mësimi i gjuhës së huaj në ciklin e ulët të arsimit të detyruar, mbështetur në përparësitë e të mësuarit të hershëm të gjuhës së huaj, është zhvilluar me sukses qysh në klasën e tretë dhe të katërt. Duke pasur parasysh moshën e nxënësve, përbërjen shumë heterogjene të klasave tona si dhe vëllimin orar vjetor (gjithsej 140 orë në dy vite) mendohet se programi i klasës së tretë dhe të katërt siguron vetëm një nivel hyrës në gjuhën franceze. Programi i klasës së pestë, sigurisht, nënkupton një rimarrje dhe konsolidim të njohurive që janë realizuar në programet pararendëse, por edhe një rritje të njohurive si gjuhësore ashtu edhe sociokulturore që stimulon interesin e nxënësve dhe motivimin e tyre në këtë nivel ku synimi kryesor mbetet komunikimi me gojë. Duke iu referuar *Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave*, për klasën e pestë mund të parashikojmë **nivelin hyrës A1** (sipas metodologjisë së degëzuar me nëndarjet A1.1 dhe A1.2), por më të lartë se A1, ndaj duke iu referuar kontekstit të shkollës sonë aktualisht dhe kushteve konkrete mund të parashikojmë një **nivel A1** si në skemën e mëposhtme:



II. Synimet e programit

a-synimet edukative

Mësuesi nëpërmjet mësimit të gjuhës së huaj krijon një atmosferë bashkëveprimi që edukon solidaritetin dhe respektimin e tjetrit, marrjen me radhë të fjalës, etj. Nëpërmjet mësimit të gjuhës, programi parashikon edhe përvetësimin e një kompetence ndërkulturore me elementë të thjeshtë të civilizimit. Kështu në mësimin e gjuhës nëpërmjet katër aftësive, mësuesi mban parasysh aspektin njohës, gjuhësor dhe emocional. Lidhur me aspektin e fundit, programi parashikon një gamë të gjerë lojërash, për të inkurajuar zhvillimin e individualitetit të nxënësit.

b-synimet didaktike

Ky program parashikon objektiva të qarta dhe të thjeshta gjuhësore që synojnë të sigurojnë përvetësimin e njohurive leksikore, morfologjike dhe të disa elementëve të thjeshtë sintaksorë. Në këtë nivel nxënësi mëson rregulla të thjeshta gramatikore në mënyrë induktive, dmth duke kaluar nga shembujt te rregulla. Programi e inicion nxënësin e kësaj moshe në veprimtari komunikimi, të cilat vazhdojnë të jenë dominuese në klasën e gjuhës së huaj. Mësuesi synon ta vërë nxënësit në situata komunikimi e ndërveprimi duke i propozuar tema që lidhen ngushtë me jetën e përditshme dhe interesat e ngushta

të tij. Duke pasur parasysh edhe dimensionin social-kulturor, programi parashikon jo vetëm sensibilizimin me kulturën e huaj (i cili është bërë tashmë në klasat pararendëse), por edhe përvetësimin e disa elementëve të thjeshtë kulturorë që lidhen me festat, zakonet, urimet, etj. në Francë, të cilët mund të lehtësojnë komunikimin e nxënësit me folës vendas në të ardhmen.

III. Përshkrimi i aftësive gjuhësore

Në këtë nivel që sipas *Kuadrit të Pëgjithshëm të Referencave*, përcaktohet si A1, pra nivelin hyrës të pasuruar me elementë plus, programi parashikon integrimin e katër aftësive, duke vënë theksin në aftësinë e të folurit që në këtë stad është më e thjeshtë.

Të dëgjuarit

Në nivelin e ndërmjetëm A1, nxënësi mund të kapë një mesazh të thjeshtë, të thënë me një ritëm jo të shpejtë dhe të shqiptuar shumë qartë.

Nxënësi i klasës së pestë është i aftë:

- të kuptojë fjalë dhe fraza shumë të thjeshta në gjuhë standarde, që lidhen me tema të njohura dhe me interes për të;
- të kuptojë dhe ndjekë udhëzime të shkurtra dhe kërkesa detyrash, të formuluar thjeshtë;
- të kuptojë pyetje apo propozime të thjeshta dhe të reagojë ndaj tyre duke u përgjigjur.

Zakonisht në këtë fazë aplikohen dialogët, në të cilët nxënësit përdorin më shumë kohën e tashme, por ndërkohë edhe kohët e tjera, si: e shkuara (*passé composé*) dhe e ardhmja (futur, futur proche). Po kështu, nxënësi fillon të përdorë gjithnjë e më shumë vetat e tjera dhe jo kryesisht vetën e parë.

Të lexuarit

Në nivelin A1, nxënësi **mund të dallojë dhe të kuptojë në një tekst fjalë dhe fraza të përdorura më parë në situata familjare. Mund të kuptojë tekste të thjeshta, mundësisht të ilustruara.**

Nxënësi i klasës së pestë është i aftë:

- të kuptojë tekste të thjeshta, relativisht të shkurtër, që lidhen me jetën e përditshme dhe interesat e tij;
- të kuptojë kërkesat e shkruara të detyrave dhe ushtrimeve të formuluar thjeshtë;
- të kuptojë letra e kartolina të thjeshta;
- të kuptojë lajmërimet të thjeshta e të shkurtra në këndin e shkollës apo parulla;
- të kuptojë tekste, tregime të shkurtra të thjeshta dhe të ilustruara (*histoire en bulles*).

Nxënësi mund të përdorë materiale didaktike, si: menu, fletëpalosje, tabela, reklama etj

Në këtë fazë mësuesi privilegjon rolin e elementëve paragjuhësorë që ndihmojnë në kapjen e kuptimit si organizimi ikonik dhe grafik në shkrim, pasi nxënësi në këtë nivel ka njohuri të kufizuara gjuhësore.

Të folurit

Në nivelin A1, nxënësi **mund të shprehë mendime dhe kërkesa të thjeshta në një kontekst të njohur e familjar, të marrë pjesë në një bisedë faktike me temë të parashikuar, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe fjalor të njohur me një bashkëbisedues që flet ngadalë dhe qartë.**

Në këtë fazë nxënësi është i aftë :

- të prezantojë veten dhe të tjerët;
- të shprehë pëlqimet dhe mospëlqimet e tij;
- të formulojë pyetje faktike apo propozime të thjeshta me fjalor të njohur;
- të përshkruajë ndodhi shumë të thjeshta, i ndihmuar edhe nga gjestet;
- të realizojë lojë në role me fjalor të thjeshtë dhe situata të thjeshta e të njohura, si: jeta shkollore, pushimet, familja, posta, biblioteka etj.

Nxënësi i klasës së pestë do të vazhdojë edhe në këtë nivel të shprehet me gabime, në të cilat mësuesi nuk duhet të ndalet shpesh, sepse dekurajon dhe çmotivon nxënësin. Sidoqoftë, ai shprehet në mënyrë të kuptueshme për bashkëfolësit e tij, kur ky i fundit i përsërit ,riformulon dhe parafrazon, kur kjo i kërkohet.

Mësuesi përdor si material didaktik dialogët, monologët, lojën në role, simulimin e situatave të njohura etj .

Të shkruarit

Niveli A1 parashikon që nxënësi **mund të shprehë me shkrim, thjesht një informacion për veten (formular, psh) si dhe të formulojë thjesht nevojat e tij. Mund të përdorë për këtë një repertor frazash të mësuara dhe të memorizuara më parë, për situata të njohura dhe të përditshme.**

Në këtë nivel nxënësi është i aftë:

- të plotësojë një formular;
- të përshkruajë veten dhe të tjerët si dhe objekte të njohura me fjalë të thjeshta, të memorizuara;
- të shkruajë letra të shkurtra e kartolina;
- të plotësojë një tregim të shkurtër të ilustruar, kur i jepen fjalët që mungojnë.

Edhe në këtë nivel veprimtaritë me shkrim do të zënë një vend modest, do të jenë të kufizuara dhe nxënësi do të vazhdojë të bëjë gabime jo vetëm të natyrës ortografike, por edhe strukturo –gjuhësore, veçanërisht në kohët foljore.

Mësuesi mund të përdorë si materiale didaktike shkrimin e lajmërimeve të shkurtra për këndin e klasës, mesazhe te shkurtra në kartolina, formularë të thjeshtë me të dhëna personale.

IV. Përmbajtja e programit

1.Përmbajtja tematike dhe leksiku

Présentation et connaissances (moi, je suis...)

- les salutations
- la famille
- la nationalité
- l'adresse, domicile

L'école

- la classe
- les copains
- les activités et le temps libre

Les repas

- le petit-déjeuner
- le déjeuner
- le goûter
- le dîner

Les nombres de 50-70

Le calendrier

- les saisons
- les mois
- les fêtes
- ma journée

Correspondance et voyage

- Les lettres
- les cartes postales
- les invitations
- les moyens de transport (je pars en...)

Les loisirs

- la musique et la danse
- le cinéma
- la télé
- la lecture

2. Aktet dhe funksionet komunikimit

- Se présenter et identifier quelqu'un
- Dire et demander l'âge
- Donner son adresse
- Décrire des objets familiers

Proposer/ accepter/refuser
Parler d'une activité, raconter au passé composé
Exprimer simplement ses goûts et préférences (j'aime/ je n'aime pas, j'adore/ je déteste
Savoir compter de 50 à 70
Dire ce que je fais...
Comprendre et rédiger une carte postale, une petite lettre

3.Strukturat gramatikore

Quel/quelle ?
Moi, toi, lui
Où ?
Et/ mais/ car/ou/donc- la coordination
Place de l'adjectif
Aller à, au, à la, aux, chez,
Venir de la, du, des
On/nous
La forme négative des verbes/ ne...pas
Le passé composé
Le futur proche
Les expressions de temps
Le genre des noms de pays
Il fait nuit, jour, froid, chaud, du vent...
Il y a /il n'y a pas
Verbes pronominaux (au présent : se laver, se lever, s'habiller)
Aimer+ verbe
Les partitifs
Verbes : prendre, mettre, acheter, venir, dire, arriver, écrire, sortir, préférer

4. Shpërndarja e orëve

Orë mësimore: 35 javë x 2 orë = 70 orë
Aspekti komunikues/kulturor 32 orë
Aspekti gjuhësor 28 orë
Orë të lira 10 orë (teste, lexime, shfaqje filmi, vizitë në muze etj.)

Aspekti fonologjik

Në këtë nivel nxënësit artikulojnë qartë, megjithatë ata kanë ende vështirësi lidhur me shqiptimin e fjalëve dhe ritmin e intonacionin e frazës. Mësuesi bën kujdes për intonacionin ngjites e zbritës në fjali pohore e pyetëse dhe vazhdon të krijojë automatizma të shqiptimit duke përdorur rimën ,por edhe dëgjimin e materialeve të shqiptuara nga folës francezë, të regjistruar në magnetofon.

Qëllimi *i orëve të lira* (rreth 14% e orëve totale), është që t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësit në përputhje me kërkesat e programit zyrtar, të miratuar nga

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për lëndën e Gjuhës Frënge dhe Udhëzimin Nr. 38, dt. 9.10.2007 i MASH për orët e lira.

Organizimi i lojërave gjuhësore me elementë që zhvillojnë të menduarit logjik dhe kritik në shërbim të një objektivi të paracaktuar; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojëra të ndryshme zbavitëse; përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënës, ashtu edhe mësimdhënien janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesi/et e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët (në formën e një projekti ose të një teme komplekse), që shfrytëzon lidhjet konceptuale të gjuhës Frënge me lëndët e tjera dhe aspektet ndërkurrikulare.

Shpërndarja dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve në vendin e duhur përgjatë procesit mësimor akademik është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar kryesisht për qëllime rutinë, të cilat nuk ndihmojnë në arritjen e objektivave të këtij programi.

V. Metodologjia e zbatimit të programit

Për realizimin e programit, mësuesi, do të zbatojë parimin e eklektizmit, dmth të kombinimit të disa metodave, duke i përshtatur ato me nevojat specifike të klasës. Megjithëse mësuesi do të vërë theksin dhe do të privilegjojë në punën e tij metodën komunikative, ai do të përdorë shpesh në këtë nivel metodën klasike duke ndërhyrë me gjuhën amtare, veçanërisht në shpjegimin e udhëzimeve dhe kërkesave të ushtrimeve e veprimtarive.

Për të krijuar një frymë besimi dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, mësuesi duhet t'i japë përparësi punës në grup dhe situatave që lidhen ngushtë me interesat e fëmijëve të kësaj moshe. Duke e vënë nxënësin në qendër të procesit mësimor dhe duke synuar zhvillimin e individualitetit të nxënësit, mësuesi do të vazhdojë t'i rezervojë një vend të konsiderueshëm aspektit ludik. Lojërat duhet të zënë një vend ende të konsiderueshëm në orën e mësimi.

Në këtë fazë, meqë aftësitë gjuhësore dhe njohëse të nxënësit janë të kufizuara për shkak të moshës së tij shumë të re, mësuesi duhet të synojë në veprimtari që stimulojnë operacione të ashtuquajtura të nivelit të ulët që lidhen me aftësitë riprodhuese dhe memorizuese, por ai do ta iniciojë nxënësin edhe në veprimtari krijuese shumë të thjeshta në ushtrime *puzzle*, ushtrime me vende bosh, me fjalë apo fjali me rend të përmbysur, etj.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i metodologjisë së zbatimit të programit është **integrimi lëndor**. Në kushtet e realizimit të procesit të të mësuarit të gjuhës së huaj, integrimi realizohet nëpërmjet rubrikës së “Civilizimit” që është pjesë e çdo uniteti didaktik. Siç e kemi shpjeguar edhe më lart në këtë rubrikë, mësuesi trajton elementë të gjeografisë, në tema të tilla, si : pushimet në breg të detit, sportet dhe pushimet malore ;

aspekte historike (p.sh. figura historike si Jeanne d’Arc, Napoleon etj) ;

aspekte kulturore (p.sh komente të fotove të kështjellave, monumenteve etj, kinemaja, programet muzikore etj) të cilat mund t'i realizojë nëpërmjet shfaqjeve të filmave, tregimeve të ilustruara, mësimi të këngëve e poezive që veçanërisht në këtë nivel janë të

shumta. Në këtë mënyrë realizohet edhe një nga kriteret kryesore të kurrikulës për gjuhën e huaj, atë të të mësuarit jo vetëm të gjuhës, por edhe nëpërmjet gjuhës.

VI. Vlerësimi

Për vlerësimin e nxënësve, në këtë fazë, mësuesi kombinon vlerësimin e vazhduar me vlerësimin e përpiktë. Ky, i fundit është shumë efikas dhe më i kapshëm se i pari, pasi integron edhe nxënësin, meqë mat realizimin e objektivave të caktuara. Një vlerësim i tillë nënkupton hartimin e testeve të qarta. Por duke pasur parasysh moshën e nxënësve ndodh që një vlerësim i tillë t'i stresojë e ndonjëherë t'i dekurajojë nxënësit. Për këtë mësuesi duhet të vlerësojë dhe masë jo vetëm njohuritë gjuhësore, por edhe ato social-kulturore, duke vlerësuar p.sh.: gjetjen dhe përgatitjen e materialeve të thjeshta didaktike nga vetë nxënësi, recitimin e një poezie, interpretimin e një këngë etj. Në këtë proces mësuesi duhet të integrojë edhe vetëvlerësimin ose bashkëvlerësimin, duke e nxitur nxënësin t'i masë ai vetë realizimet në përvetësimin e katër aftësive, duke hartuar tabela të veçanta për këtë qëllim.

Mësuesi duke mbajtur parasysh edhe një dimension afektiv të procesit mësimor duhet të bëjë kujdes në trajtimin e gabimit që të mos dekurajojë nxënësit.